



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektori@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 426

Datë: 30/3/2021

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23, paragrafi 1, alineja 1.6 dhe 1.6.1, lidhur me nenin 153 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli Drejtues, në vazhdimin e mbledhjes së datës 11.03.2021 të mbajtur me datë 19.03.2021, miratoi:

## RREGULLORE

### PËR PROCEDURËN DHE MASAT DISIPLINORE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

#### KAPITULLI

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton procedurën e përgjegjësisë disciplinore, organet shqyruese të shkeljes disciplinore, kategorizimin e shkeljeve disciplinore si dhe masat dhe ndëshkimet disciplinore ndaj studentëve.

##### Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për studentët e rregullt, studentët me korresponcencë, studentët vizitorë, si dhe për çdo student që është i regjistruar në cilindro prej niveleve të studimeve që ofrohen nga Universiteti i Prishtinës.

##### Neni 3 Parimet e përgjithshme

- Universiteti i Prishtinës (në vijim universiteti) synon të ofrojë një ambient të përshtatshëm për zhvillim akademik, si dhe trajtim të barabartë, korrekt e me dinjitet për të gjithë studentët, stafin dhe çdo vizitor që graviton në hapësirën universitare.

**RREGULLORE PËR PROCEDURËN DHE MASAT DISIPLINORE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

2. Për të përbushur qëllimin e pasqyruar në parimet e kësaj rregulloreje, universiteti ka për detyrë dhe obligim që të marrë përgjegjësi për ta mbrojtur komunitetin universitar nga dëmet, dëmtimet dhe cenimi i integritetit dhe dinjitetit në rangun personal, akademik dhe institucional.
3. Universiteti konsideron që krahas rregulloreve që sanksionojnë veprimtarinë akademike e universitare, nevoja e zbatimit të rregullave për sjelljen etike të studentëve është domosdoshmëri emancipuese, me qëllim që të arrihet mbrojtja e integritetit dhe të krijohet një ambient akademik, i cili mundëson trajtim të barabartë, korrekt dhe me dinjitet të studentëve dhe personelit akademik e jo akademik.
4. Kjo rregullore që përshkruan procedurën dhe përgjegjësitë disiplinore të studentëve, përmes së cilës universiteti do të ndërmarrë masa disiplinore, kur të njëjtat rregulla shkelen nga studentët, është hartuar mbi bazën e autoritetit që universiteti ushtron me legjisacionin në fuqi dhe me statut.
5. Parimet themelore të mishëruara në këtë rregullore janë: mosdiskriminimi, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore, qasja në arsim, etika dhe morali publik akademik, si dhe parimet e tjera procedurale të përcaktuara në Ligjin në fuqi të Procedurës së Përgjithshme Administrative.
6. Universiteti angazhohet që të krijojë mekanizma efikas për zbatimin e parimeve dhe dispozitave të kësaj rregulloreje, ku përmes këtyre mekanizmave, synohet të arrihet realizimi efektiv i autoritetit të universitetit në shërbim të interesit publik dhe duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të studentëve.

**Neni 4  
Obligimet e studentëve**

1. Studentët e Universitetit të Prishtinës obligohen t'u përbahen rregullave të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, statutit dhe rregulloreve të universitetit dhe njësisë akademike, ku janë të regjistruar, ta ruajnë imazhin e universitetit, të respekojnë të drejtat e personelit dhe studentëve tjerë, të respekojnë rregullat disiplinore dhe rregullat e përgjithshme të mirësjelljes, si dhe t'i përbushin detyrimet e parapara me planprogramin e studimeve.
2. Përveç tjerash, studentët duhet të veprojnë në atë mënyrë që të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe interesit publik si dhe imazhit dhe interesit më të mirë të universitetit.

## KAPITULLI II

### ORGANET SHQYRTUESE TË SHKELJES DISIPLINORE

#### Neni 5

##### Organet për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore

1. Organet për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore të cilat e zhvillojnë procedurën disiplinore janë:
  - 1.1. Këshilli i fakultetit i cili këshillohet nga komisioni disiplinor i njësisë akademike, si organ i shkallës së parë.
  - 1.2. Komisioni i ankesave në nivel të njësisë akademike, si organ i shkallës së dytë.

#### Neni 6

##### Përbërja e organeve për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore

1. Komisioni disiplinor si organ këshillëdhëns i njësisë akademike përbëhet nga 3 anëtarë, dy prej të cilëve duhet të kenë së paku titullin e profesorit asistent në njësinë përkatëse akademike.
2. Komisioni i ankesave në nivel të njësisë akademike përbëhet nga 3 anëtarë, dy prej të cilëve duhet të kenë së paku titullin e profesorit asistent në njësinë përkatëse akademike.

#### Neni 7

##### Mandati i organeve për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore

1. Komisioni disiplinor dhe komisioni i ankesave emërohen me mandat katërvjeçar sipas procedurës së rregullt të votimit nga këshilli i njësisë akademike.
2. Mandati i anëtarëve të komisioneve është i lidhur me mandatin e organit i cili e ka zgjedhur.
3. Mandati i anëtarëve të komisioneve përkatëse mund të përfundojë para kohe në rast të:
  - 1.1. Dorëheqjes;
  - 1.2. Shkarkimit;
  - 1.3. Arsyeve shëndetësore;
  - 1.4. Dënimit për vepër penale;
  - 1.5. Pensionimit;
  - 1.6. Vdekjes.

#### Neni 8

##### Shkeljet disiplinore

1. Shkelje disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i kryer në kundërshtim (mospërputhshmëri) me këtë rregullore dhe me aktet tjera ligjore dhe nënligjore të UP-së, të cilat përfshijnë veprimet që cenojnë parimet si në vijim:
  - a) Cenimin e integritetit personal;
  - b) Mohimin e lirisë së shprehjes;

- c) Cenimin e privatësisë;
- d) Cenimin e integritetit të universitetit;
- e) Cenimin e integritetit të personelit akademik dhe joakademik;
- f) Mostolerancën;
- g) Cenimin e pronësisë intelektuale;
- h) Keqpërdorimin e mirëbesimit financiar;
- i) Cenimin e rregullave bibliotekare dhe laboratorike;
- j) Cenimin e infrastrukturës universitare;
- k) Sjellja e pahijshme dhe joprofesionale në proceset akademike: mësim, provim, praktikë profesionale e të ngashme.

**Neni 9  
Kategorizimi i shkeljes disiplinore**

1. Shkeljet e përcaktuara në këtë rregullore kategorizohen në:
  - a) shkelje të lehta disiplinore dhe;
  - b) shkelje të rënda disiplinore.

**Neni 10  
Shkelje të lehta disiplinore**

2. Shkelje të lehta disiplinore konsiderohen veprimet apo mosveprimet, të cilat cenojnë rregullat, etikën e mirësjelljes, vlerat dhe standardet e Universitetit të Prishtinës, ndaj të cilave shqiptohen masat disiplinore të parapara në nenin 12 të kësaj rregulloreje.
3. Shkelje të lehta disiplinore konsiderohen, por nuk kufizohen vetëm në to:
  - a) sjellja jo e mirë dhe e pahijshme në objektet e universitetit/fakultetit, ku mbahen ligjëratat, ushtrimet, provimet, punët administrative dhe aktivitete të tjera;
  - b) prishja e rendit dhe qetësisë gjatë ligjëratave, në të cilat pengohet puna normale e mësimdhënësit dhe studentëve;
  - c) shkatërrimi i pa qëllimshëm i pajisjeve mësimore, laboratorëve, kompjuterëve, fondit librar në biblioteka dhe pasurisë tjetër në universitet;
  - d) pjesëmarrja në tubime në objektet ose hapësirat e universitetit, për të cilat nuk ka leje;
  - e) kryerja e aktiviteteve tjera, me të cilat shkaktohet dëm dhe cenohet autoriteti i universitetit, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve, punëtorëve tjera dhe studentëve të universitetit.

**Neni 11  
Shkelje e rëndë disiplinore**

1. Shkelje e rëndë disiplinore konsiderohen veprimet apo mosveprimet, të cilat cenojnë rëndë rregullat, etikën e mirësjelljes, vlerat dhe standardet e Universitetit të Prishtinës, ndaj të cilave shqiptohen masat disiplinore të parapara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Shkelje të rënda disiplinore konsiderohen, por nuk kufizohen vetëm në to:

- a) dhënia e shënimeve jo të sakta organeve të universitetit, me qëllim të përvetësimit të të drejtave të caktuara të studentëve;
- b) tjetërsimi dhe/ose përmirësimi i shënimeve në dokumentet e lëshuara nga universiteti;
- c) nxitja dhe/ose pjesëmarra në incidente në objektet e universitetit, ku pengohet zhvillimi i proceseve akademike, administrative dhe proceseve tjera;
- d) shkatërrimi dhe dëmtimi me qëllim i pasurisë së universitetit, përfshirë infrastrukturën, pajisjet dhe inventarin;
- e) nxitja dhe përfshirja në sjellje abuzive ndaj personelit akademik, administrativ, studentëve dhe palëve tjera që gravitojnë në universitet. Sjellje abuzive është çdo formë apo përpjekje për të ushtruar dhunë fizike ndaj të tjerëve, kërcënimet, komentet dhe ofendimet rrëth orientimit seksual, moshës, nevojave të veçanta (paaftësisë), religjionit, përkatësisë etnike;
- f) përdorimi dhe/ose posedimi i alkoolit, drogës dhe substancave tjera të palejuara në objektet e universitetit, si dhe frekuentimi i universitetit në gjendje të dehur apo të droguar, manifestuar me sjellje agresive;
- g) ndalimi ose pengimi i organizimit të procesit mësimor (ligjérata, ushtrime, kolokfiume, provime dhe lloje tjera të mësimit dhe vlerësimit);
- h) përqarje, ndërhyrje ose pengim i veprimtarive akademike, administrative, sportive, sociale, kulturore ose aktiviteteve të tjera të universitetit;
- i) përdorimi ose posedimi i mjeteve të palejuara në provime, kolokfiume ose formave tjera të vlerësimit, si për shembull, përdorimi i paautorizuar i telefonit, kalkulatorit, librave, kopjeve të ndryshme e të ngjashme;
- j) kopjimi apo tentimi për të kopjuar gjatë provimeve, kolokfiumeve, testeve ose formave tjera të vlerësimit;
- k) keqpërdorimi virtual i provimit dhe shpërndarja e testeve në rrjete sociale;
- l) hyrja në kolokfiume, provime, teste apo forma tjera të vlerësimit, në emër të dikujt tjetër si dhe përgatitja e punimit të diplomës, seminareve dhe detyrave për studentë të tjerë;
- m) huazimi apo dhënia në shfrytëzim e ID kartelës, passwordit të emailit të universitetit dhe mjeteve tjera identifikuese studentëve apo personave tjerë fizik;
- n) përdorimi i paautorizuar i mjeteve dhe resurseve të universitetit;
- o) fotokopjimi, fotografimi, incizimi dhe shpërndarja e paautorizuar e orës mësimore, materialit përgatitje të provimit dhe afatit të provimeve, testeve etj.;
- p) dorëzimi në vlerësim i punimeve, seminareve, projekteve dhe detyrave me plagjiaturë;
- q) dorëzimi në vlerësim i punimeve, prezantimeve, projekteve hulumtuese me rezultate të falsifikuara/të sajuara;
- r) fshehja dhe ndihma studentëve tjerë në kryerjen e shkeljes disiplinore;
- s) çdo veprim ose mosveprim që sjell ose ka potencial për ta sjellë universitetin ose partnerët e tij në mosrespekt ose që e dëmton ose e ka potencialin t'i dëmtojë marrëdhëniet e universitetit me komunitetet e tij;
- t) çdo shkelje e marrëveshjeve, kodeve, kontratave, vendimeve, politikave dhe procedurave të tjera të universitetit;

- u) çdo sjellje që çon në një hetim penal ose që përbën një vepër penale;
- v) mosrespektimi i ndonjë kërkese ose ndëshkimi të vendosur më parë sipas këtyre rregulloreve;
- w) veprime ose mosveprime që kërcënojnë shëndetin ose sigurinë e studentëve dhe stafit;
- x) aktivitete tjera, të cilat nuk janë përmendur në këtë rregullore, por konsiderohen si shkelje me aktet tjera të aprovuara në nivel fakulteti dhe universiteti;
- y) secili veprim që fyen rëndë integritetin e fakultetit/universitetit, personelit akademik dhe jo akademik;
- z) fotografimi, incizimi ose shpërndarja e votës në zgjedhjet studentore, apo zgjedhje të organeve tjera brenda fakultetit/universitetit;
- aa) presioni ndaj personelit akademik me qëllim të ndikimit në procedurat e vlerësimit dhe paraqitja (denoncimi) i rrejshëm i fakteve ndaj personelit akademik apo administrativ;
- bb) përdorimi i paautorizuar i emrit, logos së fakultetit apo universitetit, përfshirë hapjen e paautorizuar të llogarive në rrjete sociale në emër të organeve të UP-së;
- cc) reagime të paautorizuara në rrjete sociale në emër të organeve të UP-së, përfshirë edhe reagimin e paautorizuar në emër të përfaqësuesve të studentëve;
- dd) shkrimi dhe reagimi në rrjetet sociale apo aplikacione të ndryshme (*viber, whatsapp e të ngjashme*) në mënyrën që cenon integritetin dhe privatësinë e personelit akademik, administrativ apo studentëve.

## MASAT DISIPLINORE

### Neni 12

#### Masat disciplinore për shkelje të lehta

1. Për shkelje të lehta disciplinore shqiptohet vetëm njëra nga këto masa disciplinore:

- a) paralajmërimi verbal nga personeli i Universitetit të Prishtinës, qëllimi i të cilit është këshillimi dhe paralajmërimi i/e studentit për masa të tjera disciplinore në rast të përsëritjes së shkeljes;
- b) kërkesë për të paraqitur kërkimfalje me shkrim për ata që preken nga shkelja;
- c) vendim për të paguar çdo dëmtim ose tarifë për dëmin material të shkaktuar;
- d) vërejtje me shkrim.

### Neni 13

#### Masat disciplinore për shkelje të rënda

1. Për shkelje të rënda disciplinore shqiptohet vetëm njëra nga këto masa disciplinore:

- a) vendim për të paguar çdo dëmtim ose tarifë për dëmin material të shkaktuar;
- b) vendim për të kryer punë në komunitet, siç është angazhimi në organizimin e aktiviteteve të ndryshme edukative nga ana e universitetit dhe partnerëve të tij;
- c) ndalesë në hyrje në provime, në një apo më shumë afate të provimeve;
- d) ndalim i përkohshëm (suspendim) nga fakulteti për 6 muaj;

**RREGULLORE PËR PROCEDURËN DHE MASAT DISIPLINORE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

- e) ndalim i përkohshëm (suspendim) nga fakulteti për 1 vjet;
- f) përjashtim përgjithmonë nga fakulteti dhe universiteti, përfshirë edhe të drejtën për t'u regjistruar sërisht në universitet;
- g) humbja e të drejtës për të gjuar përkrahje financiare nga universiteti, siç është bursa universitare apo grante të ndryshme që fitohen në emër të universitetit.

**Neni 14**

**Shqiptimi dhe përshtatshmëria e masës disiplinore**

1. Masat disiplinore shqiptohen në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara.
2. Me rastin e caktimit të një mase disiplinore duhet të merren parasysh çdo rr Ethanë lehtësuese apo rënduese, si:
  - a) rrezikshmëria e shkeljes disiplinore;
  - b) shkalla e përgjegjësisë së studentit;
  - c) rr Ethanat në të cilat është kryer shkelja;
  - d) pasojat e shkaktuara;
  - e) sjellja e studentit para kryerjes së shkeljes dhe gjatë procedurës disiplinore;
  - f) nëse studenti i dyshuar për shkelje ka marrë masë disiplinore të mëparshme, e cila nuk është shlyer nga evidencat e dosjes së studentit.

**Neni 15**

**Procedimet penale**

1. Universiteti nuk ka kompetenca hetimore të karakterit penal. Këto procedura përqendrohen në faktin nëse rregullorja për përgjegjësi disiplinore është shkelur dhe nuk mund të konsiderohen si zëvendësim për një hetim ose ndjekje penale.
2. Kur shkeljet disiplinore përfshijnë ose mund të përfshijnë shkelje me nevojë për procedime penale, sekretari i fakultetit, në koordinimin me dekanin, e përcjell tek organet kompetente rastin, ndërsa komisioni disiplinor nuk duhet t'i pezullojë procedurat e brendshme për trajtimin e rastit disiplinor.

**Neni 16**

**Raportimi i shkeljes disiplinore të pretenduar**

1. Procedura e përgjegjësisë disiplinore fillon me rastin e raportimit të shkeljes së rregullave dhe parimeve të parapara me këtë rregullore.
2. Në kuadër të kësaj procedure, çdo student, personel i universitetit apo palë e përfshirë, i cili pretendon se ndaj tij, ndaj universitetit apo kulturës akademike janë shkelur të drejtat që janë sanksionuar me këtë rregullore, ka të drejtë dhe inkurajohet ta paraqesë shkeljen te komisioni disiplinor në nivel fakulteti, si organ i shkallës së parë.

3. Kur një palë raportuese raporton një shkelje, ai/ajo do të mbahet i informuar për afatet kohore që lidhen me hetimin dhe çdo proces disiplinor dhe do të njoftohet me përfundimin e procesit. Njoftimi do të jetë specifik për se cilin rast dhe do të përcaktohet duke marrë parasysh të drejtat e privatësisë për të gjitha palët dhe parimet e drejtësisë.
4. Dëshmitë e dëshmitarëve do të merren parasysh përmes deklaratave me shkrim, deklaratave në formë elektronike.
5. Universiteti do të mundësojë edhe raportimin anonim në mënyrë elektronike.
6. Universiteti nuk do të tolerojë raportime joserioze, shqetësuese ose keqdashëse.

#### **Neni 17**

#### **Procedura dhe afatet kohore për iniciimin e procedurës disiplinore**

1. Shkelja disiplinore mund të raportohet nga personeli akademik, administrativ, palët e treta apo studentët.
2. Nëse konstatohet se për rastin e paraqitur ka fakte të mjaftueshme për iniciimin e procedurës disiplinore, sekretari i fakultetit e njofton komisionin disiplinor që brenda (5) pesë ditëve të punës, pas paraqitjes së shkeljes së dyshuar, duhet të iniciojë procedurën disiplinore.
3. Procedura duhet të përfundojë brenda pesë (5), respektivisht 15 ditëve të punës, duke ndërmarrë hapat si në vijim:
  - a) njofton me shkrim personin/ studentin e dyshuar për shkelje se ndaj tij është iniciuar procedurën disiplinore;
  - b) të dyshuarit për shkelje disiplinore i jepet e drejta për t'u deklaruar;
  - c) kontakton me personin, i cili ka paraqitur shkeljen e dyshuar, duke e njoftuar me iniciimin e rastit dhe duke i dhënë mundësinë e deklarimit të tij;
  - d) kontakton dhe merr dëshmi me shkrim nga çdonjëri që mund të ofrojë dëshmi në lidhje me rastin;
  - e) komisioni disiplinor duhet të vendosë brenda 30 ditëve, prej ditës kur rasti i është paraqitur;
  - f) për shkak të kompleksitetit të çështjes disiplinore, komisioni disiplinor në shkallë të parë mund të shtyjë afatin përfundimin e procedurës disiplinore, por jo më gjatë se 30 ditë nga dita e përfundimit të afatit fillestar.
3. Me rastin e fillimit të procedurës disiplinore, komisioni obligohet të trajtojë rastin me kompetencë, besueshmëri, paanshmëri dhe në përputhje të plotë me parimet themelore të drejtësisë.

#### **Neni 18**

#### **Parashkrimi i shkeljes disiplinore**

1. Procedurat disiplinore nuk mund të iniciohen pas kalimit të këtyre periudhave kohore:

- a) dy (2) muaj nga data kur zbulohet shkelja e lehtë disiplinore;
- b) katër (4) muaj nga data kur zbulohet shkelja e rëndë disiplinore;
- c) përjashtimisht nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, për shkaqe të arsyeshme dhe të bazuara, mundësia për zhvillimin e procedurave disiplinore skadon brenda tre (3) muajve pas datës kur është kryer shkelja e lehtë dhe gjashtë (6) për shkelje të renda.

### **Neni 19**

#### **Shqyrtimi i shkeljes së pretenduar disiplinore nga komisioni disiplinor**

1. Me rastin e paraqitjes së shkeljes së pretenduar disiplinore, komisioni disiplinor do të mblidhet për shqyrtimin e rastit, verifikimin e të dhënavë, konstatimin e përputhshmërisë objektive të rastit me normat e përcaktuara me këtë rregullore, si dhe të fillojë zhvillimin e procedurës ndaj palës së pretenduar për shkelje disiplinore.
2. Procedura e përgjegjësisë disiplinore organizohet në sesione, përkatësisht në veprimet vijuese:
  - a) me rastin e konstatimit të bazës së qëndrueshme për shkelje;
  - b) me rastin e seancës ndaj palëve dhe rekomandimin e vendimit përfundimtar për këshillin e fakultetit;
  - c) në sesionet e përcaktuara si në pikat a dhe b të këtij neni mund të shqyrtohen më shumë se një rast.
3. Çdo rast i paraqitur do të trajtohet me kompetencë, besueshmëri, paanshmëri dhe në përputhje të plotë me parimet themelore të drejtësisë dhe që proklamohen në legjislacionin e aplikueshëm dhe në këtë rregullore, duke marrë në konsideratë palën raportuese dhe palën e raportuar, si dhe palët e treta që ndërlidhen me rastin e raportuar.
4. Kur një shkelje e mundshme përfshin shumë studentë, komisionet disiplinore që shqyrtojnë rastin mund të përcaktojnë nëse studentët do të konsiderohen si palë individuale apo kolektive.
5. Studentët e përfshirë si palë në një seancë disiplinore pritet që të flasin vetë dhe të jenë të gatshëm të shtrojnë argumentet e tyre. Megjithatë, një student ka të drejtë të përfaqësohet në procedurë disiplinore nga një përfaqësues i autorizuar.
6. Universiteti nuk mban të drejtën të caktojë përfaqësimin ligjor në lidhje me cilindo element të procedurave sipas kësaj rregulloreje.
7. Dështimi për të marrë pjesë në seancë nuk do ta ndalojë procedimin e seancës. Shkeljet disiplinore mund të trajtohen dhe të konstatohen edhe në mungesë të palëve.
8. Largimi i studentit nga universiteti gjatë kohës kur është në procesin e shqyrtimit për shkelje disiplinore nuk do të ndalojë domosdoshmërisht procedurat sipas kësaj rregulloreje.

9. Pas raportimit të një rasti për shkelje disiplinore, kur konstatohet se nuk ka prova të mjaftueshme, komisioni disiplinor rezervon të drejtën t'i propozoj këshillit të fakultetit mylljen e procedurës disiplinore, në mungesë të provave.

**Neni 20**

**Propozimi i masës disiplinore nga komisioni disiplinor dhe marrja e vendimit nga këshilli i fakultetit.**

1. Shqiptimi i masave disiplinore bëhet nga këshilli i njësisë akademike me propozim të komisionit disiplinor, si organ i shkallës së parë. Propozimet e komisionit disiplinor miratohen në këshillin e fakultetit.
2. Palët në procedurë kanë të drejtë t'i ankohen komisionit të ankesave në nivel të njësisë akademike, si organ i shkallës së dytë.

**Neni 21**

**Mbështetja administrative**

1. Person përgjegjës për mbarëvajtjen e takimit të komisionit disiplinor dhe komisionit të ankesave është sekretari i njësisë akademike, ku zhvillohet procedura disiplinore, i cili obligohet të sigurojë:
  - a) rregulloren për procedurën dhe masat disiplinore për studentët e UP-së;
  - b) ofrimin e dëshmive të mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës;
  - c) përgatitjen e orarit të mbarëvajtjes së takimit të komisionit disiplinor;
  - d) njoftimin për datën, kohën dhe vedin e mbajtjes së takimit për personat që kërkohet të jenë të pranishëm;
  - e) mbajtjen e procesverbalit;
  - f) dorëzimin dhe kumtimin e vendimit te personat kompetentë.

**Neni 22**

**Procedura për parashtrimin e ankesës në komisionin e ankesave**

1. Ankesën ndaj vendimit të shkallës së parë mund ta parashtrojë:
  - a) pala e dënuar për shkelje;
  - b) parashtruesi i shkeljes disiplinore.
2. Ankesa parashtrohet me shkrim në afatin prej 10 ditëve të punës, nga data e pranimit të vendimit të shkallës së parë.
3. Në ankesë duhet theksuar në mënyrë të veçantë:
  - a) vendimin, kundër të cilit paraqitet ankesa;
  - b) arsyet, ndaj të cilave është paraqitur ankesa;
  - c) dëshmitë relevante që parashtruesi i ankesës mendon se autoriteti i apelit duhet t'i marrë parasysh;

- d) përfundimin e kërkuar (anulimin e tërësishëm apo të pjesshëm të vendimit apo ndryshimin e tij);
- e) nënshkrimin e ankuesit.

**Neni 23**

**Arsyet për paraqitje në komisionin e ankesave**

1. Kundër vendimit mbi shqiptimin e masës disiplinore mund të ushtrohet ankesë për shkak të:
  - 1.1. shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje;
  - 1.2. vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe provave dhe
  - 1.3. vendimit mbi caktimin e masës disiplinore.

**Neni 24**

**Shqyrtimi i shkeljes disiplinore nga komisioni i ankesave**

1. Komisioni i ankesave vlerëson dhe shqyrton me kujdes të gjitha çështjet dhe dëshmitë që kanë të bëjnë me rastin dhe vendos:
  - a) të kontrollojë nëse ankesa është parashtuar brenda afatit të paraparë;
  - b) të kontrollojë dhe vlerësojë pjesën e vendimit të kontestuar për të parë nëse ka pasur ndonjë shkelje në procedurë;
  - c) të vlerësojë nëse është kryer shkelja disiplinore dhe të vlerësojë përshtatshmërinë e masës disiplinore të shqiptuar.
2. Komisioni i ankesave duhet që brenda afatit prej 30 ditëve prej datës së pranimit të ankesës të vendosë për rastin disiplinor.

**Neni 25**

**Kompetenca e komisionit të ankesave**

1. Komisioni i ankesave mund të marrë këto vendime:
  - a) të hedhë poshtë ankesën si të paafatshme;
  - b) të refuzojë ankesën si të pabazuar dhe e vërteton vendimin paraprak;
  - c) të pranojë pjesërisht ankesën dhe të ulë masën disiplinore;
  - d) të pranojë tërësisht ankesën dhe të shfuqizojë masën disiplinore të dhënë.
2. Vendimi nga komisioni i ankesave merret në bazë të shqyrtimit dhe vlerësimit të dëshmive me shkrim, mirëpo, në raste të caktuara, mund të pranojë dëshmi të reja apo të lejojë një dëgjim gojor nëse ka gjasa që cilado prej tyre të ndihmojë në marrjen e vendimit objektiv.

**Neni 26**

**Marrja e vendimit nga komisioni i ankesave**

1. Pas shqyrtimit të rastit, komisioni i ankesave ka kompetencë të:

**RREGULLORE PËR PROCEDURËN DHE MASAT DISIPLINORE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

- a) refuzojë ankesën, nëse është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë;
- b) nëse vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai vendos përfundimisht me një akt të ri, përmes të cilit mund të anulojë apo ndryshojet, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimore;
- c) komisioni i ankesave në asnjë rast nuk mund ta rëndoje masën disiplinore të dhënë nga komisioni disiplinor.
- d) vendimi i komisionit të ankesave formulohet dhe dorëzohet me shkrim te sekretaria, brenda 5 ditëve nga dita e marrijes së vendimit, dhe është i formës se prerë, por mund t'i nënshistrohet shqyrtimit gjyqësor.

**Neni 27**  
**Ekzekutimi dhe zbatimi i masave disiplinore**

Ekzekutimi i masës disiplinore bëhet nga dita kur vendimi merr formën e prerë.

**Neni 28**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Procedurat e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, zbatohen sipas dispozitave e ligjeve ose rregulloreve me të cilin është filluar procedura.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për procedurat dhe masat disiplinore nr. 3/531, dt.15.3.2005.

**Neni 29**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës.

